

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

NË KARRIERËN E SHFRYTËZIMIT TE GELQEROREVE PLLAKORE, ZONA MINERARE NR.426/1, OBJEKTI
"PARASPUARI", BASHKIA POLIÇAN, QARKU BERAT

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE
NË KARRIERËN E
SHFRYTËZIMIT TE
GELQEROREVE PLLAKORE,
ZONA MINERARE NR.426/1,
OBJEKTI "PARASPUARI",
BASHKIA POLIÇAN, QARKU
BERAT

Drejtoria e Shërbimeve Publike

(ndërmarrje ne varësi te bashkisë Poliçan)

Studio projektuese " Oskeola" sh.p.k
Nr.cel 068 50 95 197
Email : indrithilaj@yahoo.com

EKSPERT MIEDISORE
ZEF PISTIA
HEKURAN MUÇA



PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

NË KARRIERËN E SHFRYTËZIMIT TE GELQEROREVE PLLAKORE, ZONA MINERARE NR.426/1, OBJEKTI "PARASPUARI", BASHKIA POLIÇAN, QARKU BERAT

Te dhëna te përgjithshme dhe historiku i karrieres

I.- 1 Objekti i pajisur me leje minerare dhe mjedisore

Drejtoria e Shërbimeve Publike (ndërmarrje ne varësi te bashkisë Poliçan) bazuar ne nenin 22 "Karrierat për qëllime publike vendore ose kombëtare" dhe nenin 23 "Leja e shfrytëzimit te karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare", të Ligjit nr.10304, date 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është njoftuar me shkresën e Ministrit nr.7572/1 datë 27.05.2018, mbi te drejtën e aplikimit për Leje Minerare Shfrytëzimi për grupin e mineraleve ndërtimore për zonën minerare nr.426/1, objekti "Paraspur", Berat.

I.-2 Vendndodhja e objektit

Objekti i kerkuar ben pjese ne njesie administrative Terpan, te bashkise Poliçan, dhe ben pjese ne planshetin topografik me shkalle 1: 25 000 dhe me nomenklature K – 34 – 125 – A – c (Terpani).

Pra siç e thame edhe me siper, zona e kerkuar per shfrytezim ndodhet ne harten ne shkalle 1:25 000 me nomenklature K – 34 – 125 – A – c (Terpani).dhe kufizohet nga koordinatat e meposhteme:

Tabela Nr.1 Koordinatat e pikave qe kufizojnë zonën e shfrytëzimit

Pika	Y	X	
1	44 19 123	44 90 198	
2	44 19 084	44 90 048	
3	44 18 994	44 89 961	
4	44 18 891	44 90 115	
5	44 19 031	44 90 233	
Siperfaqja e zones te kerkuar: S = 0.035 km²			



PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

NË KARRIERËN E SHFRYTËZIMIT TE GELQEROREVE PLLAKORE, ZONA MINERARE NR.426/1, OBJEKTI "PARASPUARI", BASHKIA POLIÇAN, QARKU BERAT

Topografia dhe klima e zonës

Objekti i kërkuar bën pjese ne Zonën Lindore klimatike mesdhetare.

Klima ne rajonin ku do te kryhen punimet e shfrytëzimit dhe përpunimit te gurit gëlqeror paraqitet kontinentale me dimër relativisht te ashpër dhe te ftohte dhe vere te freskët dhe te ngrohte.

Dimri qe përgjithësisht është i ashpër dhe me lagështi shoqërohet shpesh dhe me reshje bore, te cilat disa here arrijnë trashësinë mbi 0.5m duke shkaktuar bllokimin e përkohshëm te rrugës, ndërsa vera e ngrohte me pak lagështi. Ne zone ka mbi 1750 ore ndriçim dielli, korriku 2875 ore dhe dhjetori 85 ore.

Temperatura mesatare vjetore e ajrit eshte 12.6 grade Celsius, ne Korrik dhe Gusht temperatura shkon 26-36 grade Celsius , ndersa ne Janar zbret ne 6 grade Celsius , disa here dhe grade nen zero.

Vlera mesatare e rreshjeve shkon ne 2215 mm/vit . Ne periudhen tetor-maj bien 75% e rreshjeve.

Sasia maksimale e rreshjeve eshte rregjistruar gati 178 mm shi ne 24 ore (2006).

Lageshtia e ajrit rezulton sipas stineve nga 68% - 74%.

Drejtimi I ererave eshte kryesisht Veri Perendim –Jug Lindje qe perputhet me drejtimin e pergjithshme te luginës dhe ne raste te rrallaoblik me te .

Ushtrimi i aktiviteti te shfrytëzimit dhe përpunimit te gurit gelqeror , duke marre ne konsiderate masat e parashikuara ne project , nuk do te ndikojë ne ndryshimin e parametrave fizike te ajrit dhe nuk do t'a ndote ate .

Parashikimi ne project I masave gjate proceseve teknologjike te shfrytëzimit si perdorimi i uje gjate kryerjes se proceseve teknologjike ne karriere dhe atyre te përpunimit te mëtejshëm te gurit gelqeror sistematike si dhe spërkatja e stoqeve te gëlqerorit dhe rrugëve te transportit do te parandalojnë ngritjen e pluhurit dhe ndotjen e ajrit .

Përdorimi i makinerive te zbankimit , ngarkimit dhe transportit te tipit për miniera do te beje te mundur kapjen dhe parandalimin e gazeve , qe emëtohen nga motorat me djegie te brendshme .

Bimësia.

Vendi ku kerkohet leja e shfrytëzimit eshte pothuajse i zhveshur nga bimesia . Rriten vetem pak shkurre te vogla lisi . Ne zonen e dherave (mbulesen qe nuk perfaqeson rezerva gjeologjike argjilore) rriten lule dhe barishte karakteristike te zones .Ne pjesen mbi zonen e shfrytëzimit rriten bime te tjera qe jane karakteristike per kete zone .

Studio projektuese " Oskeola" sh.p.k
Nr.cel 068 50 95 197
Email : indrithilaj@yahoo.com

EKSPERT MJEDISORE
ZEF PISTJA
HEKURAN MUÇA

